

20 HAPA PËR VITIN 2014

Përfaqësues të biznesit gjerman në Shqipëri i parashtrajnë qeverisë shqiptare sugjerimet e tyre

Ne, Kryesia e DIHA-s dhe përfaqësues të biznesit gjerman në Shqipëri, besojmë tek **Shqipëria** dhe potenciali i saj ekonomik në fusha si **logjistika, infrastruktura, shërbimet financiare, energjia, minierat, nafta/gazi, industria e lehtë, bujqësia, ndërtimi, turizmi dhe tregtia**.

Ne jemi të gatshëm **të kontribuojmë edhe më tepër gjatë vitit 2014** për të mbështetur zhvillimin ekonomik të Shqipërisë nëpërmjet investimeve të reja, si dhe për të ndihmuar në afrimin e Shqipërisë drejt BE-së.

Interesi për investime të mëtejshme nga kompanitë gjermane në Shqipëri, varet kryesisht nga dy faktorë:

- 1) Ekzistenca e një **kuadri të përgjithshëm** strukturor dhe ligjor **të besueshëm**, në përputhje me standardet europiane.
- 2) **Përvoja pozitive** e kompanive gjermane që operojnë tashmë në Shqipëri.

Ndihma e qeverisë shqiptare është e nevojshme. Ajo mund të krijojë një klimë biznesi të shëndetshme, në të cilën kapitali i investuar dhe kuadri ligjor janë të mbrojtur nga arbitrariteti, korrupsioni dhe kriminaliteti, nëpërmjet një **sistemi ligjor të besueshëm, transparent dhe të pavarur**. Gjithashtu krijimi i një **administratë publike profesionale** mund të lehtësojë dhe mbështesë aktivitetin ekonomik.

Duke u nisur nga përvoja personale e anëtarëve tanë, po Ju prezantojmë **20 propozimet** për veprim në **6 fushat** kryesore për zhvillimin ekonomik. Nëse qeveria shqiptare arrin të ndërmarrë reforma për të ndjekur këto sugjerime, atëherë potenciali, reputacioni ndërkombëtar si dhe atraktiviteti i Shqipërisë do të forcohen, investimet dhe bashkëpunimi do të lehtësohen, **si dhe kushtet e jetesës në vend do të përmirësohen**.

Tani është koha për të vepruar. Ne, përfaqësuesit e biznesit gjerman në Shqipëri jemi gati.

Tiranë, më 22 janar 2014

Rolf Castro-Vasquez
President i DIHA-s
(i nënshkruar)

Jens Ströber
Zv. President i DIHA-s
(i nënshkruar)

KOMUNIKIMI DHE MARËDHËNIET ME PUBLIKUN

Komunikimi i mirë është një aspekt i rëndësishëm i modernizimit, e për këtë qëllim është renditur i pari. Kemi vënë re me kënaqësi një politikë më të hapur komunikimi, e cila do të sjellë ndikim në bashkëpunimin tonë dhe imazhin e Shqipërisë në botë.

1. **Kanalet bilaterale të komunikimit** duhet të **forcohen më tej** nga qeveria. Ambasada Gjermane dhe DIHA informohen vazhdimisht dhe prej kohësh mbi kërkesat dhe shqetësimet e bizneseve dhe investitorëve gjermanë dhe janë të gatshëm, të ndajnë përvojën e tyre në formë këshillimi. Do të ishte mirë që nëpër ministri, si dhe në dikastere të rëndësishme, të caktohej një person kontakti (qendror).
2. Komunikimi me të tretët duhet të jetë i vazhdueshëm. Bizneset gjermane janë gati të marrin pjesë aktivisht në **forume si Këshilli Ekonomik Kombëtar**, për të bërë të mundur ndër të tjera, përcimin e informacioneve mbi masat e marra nga shteti shqiptar, tek investitorët potencialë.
3. Do të ishte e këshillueshme që qeveria dhe bizneset shqiptare të merrnin pjesë edhe më shumë në **aktivitete e panairë në Gjermani**. Ambasada Gjermane dhe DIHA vihen në dispozicion për mbështetje dhe këshillim.

KUADRI LIGJOR

Nuk është e nevojshme të theksohet rëndësia thelbësore e shtetit ligjor si dhe çështjeve të tilla si ajo e pronësisë mbi tokën për investitorët. Reformat janë të domosdoshme. Në mënyrë të veçantë vlen të vlerësohen iniciativat e fundit të qeverisë për luftën ndaj korrupsionit.

4. Këshillohet të vazhdohet në rrugën e nisur, **të zbatohen me përpikmëri ligjet, vendimet gjyqësore, si dhe udhëzimet** në të gjitha fushat, të merren masa për të mbështetur pushtetin ekzekutiv në të gjitha aspektet, nga e drejta penale tek ligji i imunitetit, rregullimi i trafikut rrugor, apo e drejta për ndërtim.
5. Është e nevojshme të vazhdojë përmirësimi i **profesionalizimit të sistemit gjyqësor**, duke filluar nga përzgjedhja dhe arsimimi i gjyqtarëve dhe duke vazhduar me monitorimin e vazhdueshëm të tyre.
6. Krijimi i mirëpritur i **Gjykatës Administrative** duhet të ndiqet nga masa mbështetëse praktike, në mënyrë që gjykatat të shndërrohen në instrumente vërtet profesionalë dhe eficientë të shtetit ligjor.
7. Masat e marra për rregullimin e **çështjeve të pronësisë** duhet të zhvillohen në mënyrë të matshme, me qëllim që të rritet siguria për investime.
8. **Ligji për nëpunësin publik** duhet të zbatohet, me qëllim rritjen e nivelit të profesionalizmit në administratën publike, si një partner shumë i rëndësishëm i ekonomisë, në mënyrë që punësimi, promovimet, apo largimet nga puna të bëhen vetëm sipas **kritereve të qarta dhe transparente**.

HYRJA NË TREG

Bizneset gjermane studiojnë me kujdes eksperiencat e kompanive të tjera, si dhe klimën e biznesit, në vendet që ata shqyrtojnë si të mundshme për të investuar nëpër botë. Barrierat burokratike apo parregullsitë e ndryshme ndikojnë negativisht në nivelin e investimeve të reja.

9. Hapat e fundit pozitivë që inkurajojnë hyrjen e investitorëve të rinj në treg, **modernizimet** si kompjuterizimi apo sistemi „one-stop-shop“ për marrjen e licencave dhe lejeve të ndryshme, duhet të zhvillohen edhe më tej. Gjithashtu, një nevojë urgjente është edhe përmirësimi i shërbimeve online.
10. Është e nevojshme që **tenderimet dhe licensimet** e bizneseve të monitorohen me shumë kujdes nga autoritetet përkatëse, në mënyrë që të sigurohet transparencë dhe konkurrencë e ndershme përgjatë gjithë procesit.

11. Dhënia e **licencave dhe koncesioneve** duhet të bëhet në mënyrë të **besueshme**; nëse është e nevojshme të bëhen verifikime, të cilat duhen trajtuar në përputhje me parimet e shtetit ligjor, në mënyrë të besueshme dhe pa vonesë.

12. Shqipëria duhet të **hapë** shpejt **tregjet e pasurive natyrore**, duke i rregulluar në mënyrë më **transparente**, me qëllim që të përdoret ky treg me potencial të lartë, për të tërhequr investime të huaja në vend.

13. Ne përgëzojmë faktin që qeveria u ndërgjegjësua lidhur me rëndësinë e **zhvillimit të qëndrueshëm, mbrojtjes së mjedisit** (deponimi i mbetjeve urbane dhe ujësjellës-kanalizimet), si dhe zhvillimit të **infrastrukturës** moderne, si të domosdoshme për të tërhequr investime të reja, si dhe e inkurajojmë atë të marrë masa të mëtejshme në këtë drejtim.

TAKSIMI DHE DOGANAT

Këto dy aspekte kanë një rëndësi thelbësore për të gjitha kompanitë që operojnë në Shqipëri.

14. Është e nevojshme që reformat strukturore të administratës tatimore dhe doganore, si partnerë të sipërmarrjes, të synojnë **rritjen e profesionalizmit** të personelit, **vendimmarrje objektive**, si dhe **rritje të matshme të eficiencës**.

15. Pa dashur të komentojmë diskutimet aktuale mbi reformat dhe sistemin tatimor, do të donim të bënim të qartë: e rëndësishme është **transparenca** dhe **besueshmëria** në sistem. Mbledhja e tatimeve, taksave dhe tarifave doganore duhet të bëhet tanimë, sipas kriterëve të qarta, të besueshme dhe të njëjta për të gjithë. **Drejtësia tatimore** është një detyrë urgjente që shtrohet për Shqipërinë dhe arrihet nëpërmjet **mbulimit dhe kontrollit më të mirë** të subjekteve tatimore.

16. Pas identifikimit dhe listimit të kompanive me **TVSh të rimbursueshme**, duhet të fillojë procesi i pagimit të këtyre detyrimeve. Situata e vështirë e buxhetit të shtetit është tashmë e qartë për kompanitë.

17. Autoritetet doganore duhet të **rikonsiderojnë sistemin e çmimeve të referencës** duke qenë se raportohen raste të mospranimi të faturave të rregullta në mënyrë arbitrare.

MARËDHËNIET FINANCIARE ME KOMPANITË

Për të marrë një vendim për investim, janë shumë të rëndësishme përvojat e mëparshme lidhur me pagesat.

18. Ne përgëzojmë deklaratën e qeverisë, se **pagesat e papaguara në kuadër të prokurimit dhe investimeve publike** do të kryhen dhe do të inkurajonim fillimin sa më të shpejtë të tyre.

ARSIMI

Me qëllim zhvillimin e qëndrueshëm dhe vazhdueshmërinë e investimeve, kompanitë gjermane vlerësojnë si shumë të rëndësishëm arsimin. Modele, si ai i sistemit dual të arsimit profesional, mund të kthehen në një faktor tërheqës për të investuar në Shqipëri.

19. **Bashkëpunimi me Gjermaninë** për të reformuar sistemin arsimor profesional duhet të forcohet. Ne përgëzojmë masat e marra deri tani dhe ofrojmë mbështetje dhe bashkëpunim të mëtejshëm.

20. Sistemi arsimor duhet tu përshtatet edhe më tepër **kërkesave konkrete të kompanive** për fuqi punëtore, në mënyrë që të shfrytëzohet sa më mirë potenciali i lartë i moshës së re në vend.